



Një Zot, shumë emra

Description

Umar F. Abdullah

Artikull i shkëputur Shkëputur nga revista “Season”, Spring-Summer 2004, f. 44-54

Në vorbullën e ngjarjeve aktuale dhe diskutimit mbi përplasjen e qytetërimeve, njerëzit shpesh kërkojnë të kuptojnë se çfarë adhurojnë muslimanët. Shumë çifutë, të krishterë, dhe muslimanë pohojnë me të drejtë se secili prej besimeve të tyre thërret Zotin e Ibrahimit, por shumë individë në mesin e të djalhtës fetare të Amerikës gjithnjë e më tepër këmbëngulin në të kundërtën e këtij mendimi të përgjithshëm. Për Pat Robertsonin e Bashkësisë së Krishterë problemet e botës vërtiten rreth çështjes “nëse është Hubali, zoti i hënës i Mekës që njihet si Allahu¹ më i larti apo Jehovahi Judaiko-Kristian, Zoti i Biblës.” Franklin Graham – i biri i Billi Graham-it dhe evangjelist i mirënjohur i cili drejtoi lutjen në ceremoninë presidenciale të Xhorxh W. Bushit në vitin 2001 – ngulmon se të krishterët dhe muslimanët adhurojnë zota të ndryshëm. Në të njëjtën rrymë, William Boykin-i, një gjeneral i rëndësishëm i Pentagonit u bë famëkeq duke e shpallur Zotin e tij si një “Zot të vërtetë” dhe “ më të madh” se Zotin e muslimanëve, të cilin ai e mendonte si një idhull të thjeshtë, deklaratë provokuese për të cilën qeveria e Bush-Cheney-it refuzoi ta kritikonte dhe ta vendoste përpara përgjegjësisë.²

Fakti se *Allahu* dhe Zoti Biblik janë i njëjti është e qartë prej etimologjisë Biblike.³ Nga pikëpamja e fesë islame dhe historisë së shpëtimit,⁴ është i papranueshëm të menduarit e Zotit Biblik dhe atij të Kuranit ndryshe nga Një i vetëm, me gjithë faktin se, vitet e fundit, shumë muslimanë anglishtfolës kanë zhvilluar një traditë problematike të shmangies së fjalës “God” (në shqip Zot) nën supozimin e gabuar se vetëm fjala arabe *Allah* ruan kuptimin gjuhësor të origjinalitetit teologjik të fjalës.

Emrat e bukur të Zotit nuk janë një fenomen unikë vetëm për Biblën apo në Kuranin dhe as për ndonjë besim apo grupe gjuhësh njerëzore. Gjuhët semite – si hebraishtja, aramaishtja, dhe arabishtja – zotërojnë leksik të pasur të emrave të shenjtë, por këto gjuhë nuk kanë krijuar ndonjë monopol mbi

Zotin në përdorimin e tyre. Tek e fundit i gjithë njerëzimi ndan një trashëgimi të njohurit të Qenies Supreme dhe të qenit të aftë ta cilësojnë Atë me emrat e duhur, të cilët – nga këndvështrimi islam – reflektojnë njohjen e brendshme të njerëzimit për Zotin, e përforcuar kjo, nga shoqërimi i largët i saj me trashëgiminë e hershme të profecisë së përbotshme. Sa për fjalën angleze “God” (Zot) ajo ka rrënjë mjaft të lashta, i përket thesarit të emrave të shenjtë të vjetër dhe është një ndër emërtimet më shprehëse për Qenien Supreme. Mospëlqimi i vazhdueshëm në radhët e shumë muslimanëve anglishtfolës për të pranuar fjalën “God” (Zot) në fjalorin e tyre shërben vetëm për të fuqizuar pretendimet e paarsyeshme në fushën e të djathtës fetare. Për muslimanët anglishtfolës është e rëndësishme të jenë koherentë, dhe përdorimi i fjalës “God” (Zot) është një hap i madh në këtë drejtim.

Simpoziumi i feve Abrahamike

Sot është bërë pjesë e leksikut të pranuar gjerësisht, të folurit mbi “fetë abrahamike” duke qenë se vetë shprehja tregon se Judaizmi, Krishterimi dhe Islami i besojnë Zotit të Abrahamit dhe ndajnë një mori vlerash e besimesh monoteiste. Kurani e quan Islamin fenë e Abrahamit:

“Pastaj, ty të shpallëm: ‘Ndiqe fenë e drejtë të Ibrahimit, se ai nuk ka qenë nga idhujtarët (as jehudi as i krishter).’”⁵ Ideja se muslimanët adhurojnë Zotin e Abrahamit është aq në brendësi të Islamit sa edhe fëmijët muslimanë nëpër shkolla e njohin mirë. Muslimanët dërgojnë përsëritje mbi Abrahamin dhe familjen e tij në lutjet e tyre të përditshme, dhe ritet vjetore të pelegrinazhit në Mekë e në shtëpinë e Abrahamit (Qaben) lidhen gjithkund me historinë e Abrahamit. Shkrimet e shenjtë islame pohojnë vazhdimisht se Islami paraqet një model të pacenuar të sistemit fetar Abrahamik⁶. Ai i urdhëron muslimanët të shfaqin besnikërinë e tyre ndaj Zotit të Abrahamit dhe udhëzimit të tij të përhershëm: “Ju (besimtarë) thuani: ‘Ne i besuam Allahut, atë që na u shpall neve, atë që iu shpall Ibrahimit, Ismailit, Is’hakut, Jakubit dhe pasardhësve (të Jakubit që ishin të ndarë në dymbëdhjetë kabile), atë që i është dhënë Musait, Isait dhe atë që iu është dhënë nga Zoti i tyre pejgamberëve, ne nuk bëjmë dallim në asnjërin prej tyre dhe ne vetëm Atij i jemi bindur.’”⁷

Nga pikëpamja kuranore, muslimanët, të krishterët dhe hebrenjtë duhet të pajtohen pa vështirësi në atë se ata të gjithë i kthehen Zotit të Abrahamit, pavarësisht ndryshimeve rituale e teologjike. Diskutimet historike ndërmjet besimeve nuk kanë nxjerrë ndonjë përfundim se me çfarë emri ta thërrasin Zotin e Abrahamit. Për muslimanët koncepti Islam i historisë së shpëtimit i ka rrënjët në bindjen se ekziston një kohë e gjatë midis shpalljes së Muhamedit (paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të) dhe shpalljeve më të hershme të Abrahamit, Moisiut, Jezuit dhe të profetëve biblikë e jobiblikë. Kurani i udhëzon muslimanët që të pranojnë hapur dhe menjëherë se Zoti i tyre dhe Zoti i pasuesve të feve biblike – hebrenjtë dhe të krishterët – është i njëjtë: “Mos debato me banorët e Librit veçse në mënyrën më të mirë, me përjashtim të atyre që janë mizorë dhe thuajuni: ‘Ne i besuam asaj që na u zbrit dhe që u zbrit juve dhe se Zoti ynë dhe Zoti juaj është një, dhe se ne i jemi dorëzuar Atij.’” (Kuran 29:46)

Allahu dhe emrat biblikë të Zotit

Fjala arabe Allah është emri i hyjnor me i përdorur në shkrimet e shenjtë islame dhe ka një shenjtëri unike jo vetëm për muslimanët por gjithashtu edhe për hebrenjtë dhe për të krishterët arabishtfolës, të

cilët e kanë përdorur fjalën Allah prej shumë kohësh. Për muslimanët fjala Allah është gjithëpërfshirëse e emrave të Zotit, që përmban të gjithë emrat dhe atributet e tjera. Në përputhje me përdorimin tradicional arab, fjala Allah mund t'i drejtohet vetëm krijuesit dhe asnjë qenieje tjetër, çkado qoftë engjëjlore, njerëzore me shpirt apo pa shpirt, reale apo imagjinare.

Edhe në Arabinë idhujtare paraislamike Allahu nderohej si krijuesi i tokës dhe i qiejve dhe zoti i botëve. Në dallim nga kultet e qindra zotave më të vegjël paganë, adhurim arab paraislamik i Allahut nuk shoqërohej asnjëherë me ndonjë idhull, as me Hubalin (zoti i Hënës, perëndi mekase sipas Pat Robertson, të cilin ai gabimisht e identifikon si Allahun).

Hubali ishte kryeidhulli i Mekës pagane por nuk ka patur ndonjë lidhje historike apo teologjike me Allahun apo, për sa u përmend me Hënën. Hubali nderohej si Zoti i parashikimit të së ardhmes dhe kulti i tij relativisht i ri u bë i njohur për Mekën vetëm disa gjenerata para kohës së Muhamedit, me një origjinë të mundshme Moabitiane(Moabites), ose mesopotamiane.

Arabishtja është gjuhë semite, e vjetër dhe shumë e pasur, shumë e afërt me hebraishten biblike, aramaishten, dhe siriakishten⁹. Etimologjikisht fjala Allah ka të njëjtën rrënjë me fjalët biblike Elohim, Ha-Elohim, Ha-Eloh (të gjitha nënkuptojnë Zot), të përdorura nga profetët hebrej dhe me fjalën Alaha të aramaishtes dhe siriakishtes, të përdorur nga Gjon Pagëzori dhe Jezui. Elohim rrjedh nga Eloh (Zot në hebraishte), Alaha është një formë më e theksuar e Alah (Zot në aramaishte dhe siriakishte) ndërsa fjala Allah lidhet me fjalën Ilah (Zot në arabisht). Të tria këto fjalë semite për Zotin – Eloh, Alah dhe Ilah janë etimologjikisht të njëjta. Ndryshimet e tyre të vogla të çojnë në shqiptime të ndryshme në përputhje me ndryshimet morfologjike të secilës gjuhë. Sipas të dhënave ato janë variante të përafërta të së njëjtës rrënjë, ashtu si psh në latinisht, spanjisht dhe italisht përkatësisht Deus, Dios, Dio ose në anglisht dhe gjermanisht gjenden God dhe Gott. Elohim, Alaha dhe Allah janë të gjitha fjalë afërta të cilat kanë një rrënjë të përbashkët protosemite që sipas një vëzhgimi të zakonshëm është rrënja LH, e cila mbart kuptimin parësor “me adhuruar”. Kuptimi thelbësor i tre fjalëve abrahamike për Zotin- Elohim, Alaha dhe Allah- është “Ai të cilit i takon adhurimi”.

Elohim haset më shumë se dy mijë herë në Dhiatën e Vjetër dhe është përkthyer God (Zot) në anglisht. Ashtu sikurse Kurani edhe Bibla përmban një numër të madh emrash të shenjtë: “Zoti i përhershëm” (Elohi qedem), “Ai që jeton në përjetësi” (Hay ha-olam), “Zoti i përjetësisë”(El alam), “I shenjtë i Izraelit”(Qadosh Yisra’el), “Mbreti i Madh”(Melek Rab), “Zoti i plotfuqishëm”(El Shaddai), “I Pathyeshmi, fuqiploti”(El Gebbor), “Zoti, më i larti”(El Elyon), etj. Tetragrami YHWH është fjala më e përdorur për Zotin në Biblën hebreje, por është përkthyer “Lord” dhe jo “God” e në disa raste “Jehovah”. Këmbëngulja midis elementëve të së djathtës fetare në përdorimin e fjalës “Judeo-Kristiane Jehovah” përkundëjt fjalës arabe Allah është një interpretim i kufizuar i traditës judeo-kristiane duke qenë se pak hebrej dhe sigurisht jo të gjithë krishterët do të ishin të kënaqur me përkthimin e fjalës biblike “Lord” në Jehovah. Fjala “Jehovah” si e tillë nuk ndeshet në Bibël, por është një formë eksperimentale e tetragramit YHWH të cilën dija bashkëkohore e përcakton si Yahveh – Ai që është ose Ai që jep jetë – sipas një foljeje të vjetër hebreje “me qenë”. Megjithatë tradita rabinike, i referohet tetragramit si mjaft të shenjtë aq sa ai u komentua si “Lord”, por pa u u përmendur apo shqiptuar me zë të lartë¹⁰. Me gjithë këto Bibla deklaron se “YHWH është vetë Elohim” (Deut 4:35); kështu, nga këndvështrimi i Biblës nuk ka ndonjë ndryshim teologjik midis YHWH dhe Elohim, i cili, siç u tha më lart është i të njëjtit burim gjuhësor me fjalën arabe Allah.

Emrat e bukur të Zotit të Abrahamit

Në shkrimet e shenjta Islame është i mirëqenë fakti se Zoti i Abrahamit ka shumë emra: “Ai është Allahu, nuk ka Zot pos Tij. Atij I takojnë emrat më të bukur.”¹¹ Emrat e Tij të shumtë kanë një efektshmëri të madhe dhe krijojnë një rrugë të veçantë shpirtërore. Në tërësi ata pohojnë përsosmërinë më të lartë të Zotit dhe përsosin njohjen e thellë të bukurisë dhe madhësisë së Tij. Ata janë mënyra mjaft të fuqishme të frymëzimit dhe lehtësojnë afrimin me Zotin: “Allahu ka emrat më të mirë, andaj thirrreni Atë me ata.”¹² emrat e bukur të Tij krijojnë një thesar të përjetshëm teologjik: *Ai është Allahu që nuk ka zot tjetër; vetëm Ai, që e di të fshehtën dhe të dukshmen; Ai është Mëshiruesi, Mëshirëbërësi! Ai është Allahu që nuk ka Zot tjetër përveç Tij, sundues I përgjithshëm, I pastër (prej të metave që I mvishen), shpëtimtar(që I shpëton njerëzit prej ndëshkimit të padrejtë), siguruës(që siguroi njerëzit me premtimin e vet dhe peygamberët me mrekulli), mbikëqyrës(që mbikqyr dhe përcjell çdo send), I plotfuqishëm, mbizotëruës, I madhërisëm. I lartësuar është Allahu nga çka I shoqërojnë! Ai është Allahu, Krijuesi, Shpikësi, Formësuesi. Të Tij janë emrat më të bukur . Atë (Allahun) e madhëron çka ka në qiej e në tokë dhe Ai është ngadhënjyesi, i urti.*¹³ Përgjithësisht muslimanët besojnë se Zoti ka nëntëdhjetë e nëntë emra, bazuar në një shprehje të profetit Muhamed a.s: “Zoti ka nëntëdhjetë e nëntë emra – njëqind pa një; kushdo që ruan (shenjtërinë e tyre) do të hyjë në xhenet. Zoti është Unik dhe e do atë që është unike.” Por emrat e njohur të Zotit në shkrimet e shenjta janë më shumë se nëntëdhjetë e nëntë. Komentuesit e vjetër i kanë kushtuar vëmendje këtij fakti dhe kanë nxjerrë në pah se tradita profetike e nëntëdhjetë e nëntë emrave nuk ka si qëllim që të kufizojë në një numër të caktuar emrat e shenjtë, por të tregojë se midis emrave të panumërt të Zotit, nëntëdhjetë e nëntë janë të dallueshëm dhe po të mësohen përmendësh e të ruhen shenjtërisht janë një rrugë drejt shpëtimit. Një tjetër traditë profetike tregon qartazi se emrat e Zotit nuk janë të kufizuar në numër, por përfshijnë emra të fshehtë e të tjerë që i shoqërohen vetëm Zotit ose pjesëve të veçanta të krijimit të Tij. Sipas kësaj tradite Profeti a.s e thërret Zotin duke thënë: “Të lutem Ty me çdo emër që është i Yti, e me të cilin ke quajtur veten, të cilin ke zbritur në librin tënd, të cilin ia ke mësuar ndonjëris prej krijesave të tua, apo me atë për të cilin dijeni ke vetëm Ti, që ta bësh Kuranin pranverë të zemrës time, dritë të shikimit tim, shërim të zemrës sime, heqës të ankthit e trishtimit tim.”

Trashëgimia e panumërt njerëzore e emrave të shenjtë

Në kuptimin kuranor të botës çdo gjë në qiej e në tokë është mbrujtur me dijen e Zotit dhe tregon madhësitinë e Tij; në mënyrë të ngjashme, njohja e vetvetishme e Qenies Supreme është mbjellë në çdo shpirt njerëzor si një anë e brendshme e natyrës njerëzore.¹⁶ Veç kësaj, të gjithë popujt në tokë kanë pasur të dërguar të frymëzuar prej Zotit gjatë rrjedhës së historisë njerëzore apo parahistorisë.¹⁷ Si pasojë, Zoti dhe emrat e tij janë pjesë e një trashëgimie njerëzore universale. Ata nuk janë të njëjtë për të gjithë dhe as fetë Abrahamike nuk janë të vetmet mbajtëse të emrave të shenjtë që shprehin përsosmërinë dhe madhësitinë e Zotit.

Fetë e shumta primitive në botë përmbajnë qindra emra për Zotin e që dëshmojnë për njësinë, përhershmërinë, përjetësinë, plotfuqishmërinë, gjithëdijen, gjithëpraninë, mirësinë dhe drejtësinë e Tij. Tek fetë primitive ekziston një model i dallueshëm qartë që e konsideron Qenien Supreme si burimin e të gjithë dijes jetësore, normave morale dhe traditave shoqërore thelbësore. Ashtu si paganizmi arab

paraislamik fetë primitive i shoqërojnë Zotit në adhurim idhuj njerëz, shpirta më të vegjël dhe ndërmjetës, megjithëse atyre u mungojnë tempujt madhështorë, tipikë për fetë politeiste të shumë qytetërimeve antike. Shumë fe primitive përkujtojnë kohën e qëmotshme të “fesë së lashtë” kur midis Qenies Supreme dhe stërgjyshërve të tyre kishte harmoni, një lumturi të pacenuar, të cilës i erdhi fundi përmes keqbërjes, ndarjes dhe tjetërsimit.¹⁸ Fetë primitive dëshmojnë për një njohje praktike të Zotit pa teologjitë metafizike të ndërlikuara të popujve të qytetëruar. Për sa i përket kultit arab paraislamik, Allah, fetë primitive i shmangen njësoj shoqërimit të Zotit krijues me idhuj, ikona(ose shëmbëllime) apo figura pasi këmbëngulin se Ai nuk mund të shihet me sy e as të preket me duart e njeriut. Tributë Nilotike të Sudanit jugor ruajnë një besim të hershëm në “Zotin e madh që krijoi njerëzimin” dhe pavarësisht se i shoqërojnë atij ndërmjetësues ata pranojnë se Ai është i përjetshëm, pa origjinë apo ngjashmëri, i gjithëdijshëm dhe Fuqiplotë, ruajtës i rendit moral.

Rreth vitit 1906 e.r.s. një antropolog evropian studioi një prej fiseve nilotike, Shilukan, dhe gjatë kësaj kohe pyeti një djalë 6-vjeçar, banor të fisit, se kush e kishte krijuar. Djali i vogël u përgjigj pa hezitim: “Më ka krijuar Dywok (Zoti)”. Antropologu e nxiti më tej duke e pyetur se si ishte Dywok-u dhe nga vinte Ai. Me një vetëbesim prej fëmije djali u kundërpërgjigj se ai vetë nuk e dinte, por i ati duhet ta dinte patjetër. Për habinë e tij, as i ati, as ndonjë i afërm përreth nuk gjenin përgjigje, por djali i vogël vazhdoi te pyeste derisa, më ne fund e çoi çështjen para pleqve të fisit. Ata u përgjigjën: Dywok-u, ne vetëm dimë që ai ekziston. Dimë se Ai krijoi qiellin që shikon lart, yjet, të gjitha kafshët, madje edhe njerëzit – njëlloj të zinj e të bardhë – por se kush është në të vërtetë, këtë s’mund ta thotë asnjë në Shiluk. Asnjë nuk e ka parë Atë. Ajo që dimë është se Dywok-u ekziston dhe ka krijuar gjithçka. Edhe nëse ti nuk e shikon, Ai është aty... si flladi që fryn. Edhe pse askush nuk mund ta shikojë, sidoqoftë ai fryn. Askush s’ka dyshim për këtë.¹⁹

Fetë primitive kanë plot emra për Zotin. “Krijuesi” dhe “Bërësi” janë pothuajse universal. Amerikanët vendas kishin shumë emra për Zotin. Cheyenne-i e quante “Krijuesin e universit” dhe “Zotin e gjithë qiellit e tokës”. Maidutë kalifornianë e quanin “Sundimtarin e botës”. Foxi e quante “Udhëzuesi” dhe “Shpirti i mirë”. Lenape e quante “Krijuesi ynë”, “Ai të cilit i lutemi”, “Fryma e pastër” dhe “Ai të cilit i përkasim”. Disa bushmenë të Afrikës së Jugut dhe pigmenët e Gabonit e quanin “Zoti i çdo gjëje”. Samoyedët siberianë e njihnin si “Krijuesi i jetës”. Ainutë nga Japonia e quanin “Krijuesi hyjnor i botëve”, “Zoti i shenjtë i qiellit”, “Frymëzuesi” dhe “Mbrotjesi”. Wirydyuri-t e Australisë e quanin “I përjetshmi” dhe një sërë fisesh aborigjene e përcaktonin si “Ndërtuesi i madh”, “Krijuesi i madh”, megjithëse disa fise aborigjene dhe bushmenët afrikanë e konsideronin emrin e Krijuesit si të padhunueshëm (tabu) dhe e thërrisnin vetëm midis meshkujve të rritur, duke e mbajtur të fshehtë nga gratë, fëmijët dhe të huajt.

Qytetërimet e lashta, gjithashtu dëshmojnë për një njohje të hershme të “të vetmit”. Megjithëse egjiptianët e lashtë ishin politeistë, gjuha e tyre përmbante emra dhe artibute të pasura për Qenien Supreme, të dallueshëm prej zotave të mishëruar të tempullit të tyre. Gjuha e lashtë egjiptiane ishte e pasur me sinonime të pafund për Zotin (*Neter, Sha’, Khabkhab, Hephep, Shesa, Sedga, Saj, Nethraj, Nekhbaj, Khetraraj, Itnuw etj*). Ata kishin emra për “Krijuesin”(Kewen, Kun, Nehef), “Krijesat e Zotit” (Nebirut) dhe “Krijuesi i trajtave” (Nebi). Ata thërrisnin “Zotin e Lartë” (Neter ‘A), “Zotin”(Nebu), “Hyjnia i Paraekzistencës” (Nun, Hahu), “i mëshirshmi i shenjtë”(Hetefi), “Shkatërruesi hyjnor”(Hetem), “Zoti i të vërtetës dhe i ekuilibrit”(Sema Ma’at), “Zoti i njerëzimit”(Itmu), dhe “Zoti i gjithçkaje” (Neberdher).²⁰

Kinezët e lashtë adhuronin një “Krijues” të personalizuar, (ose) individualizuar (Tsao wu che), “Sundimtarin e qiellit” (Shang Ti), “Zot i qiellit,parajsës”(T’ien Ti), dhe “Zotin”(Ti), ndonëse “Qielli”(T’ien)

u bë më vonë emri më i zakonshëm kinez për Zotin dhe ndonjëherë shprehte besimet astrologjike. Por, një fjalor i vjetër kinez shprehet për “Qiellin,”(T’ien), “I madhëruari në më të lartën e madhështisë së tij. Ideograma e tij ndërthur dy simbole që kanë kuptimin ‘Ai, më i larti.’ ” Disa dijetarë të vjetër kinezë shkruajnë se fjala “Qiell”(T’ien) ka zëvendësuar “Sundimtarin e qiellit” (Shang Ti) në të shkuarën sepse “nuk është e lejueshme që emri *Shang Ti* të përmendet në mënyrë të shkujdesur. Prandaj, ne e thërrasim Atë me emrin e vendit ku Ai qëndron, që është qielli, pra *T’ien* në analogji me ‘pallati mbretëror’që nënkupton ‘Perandorin.’ ”

Vedat e shenjta të Indisë së lashtë përmbajnë një fjalor të rëndësishëm të emrave për Qenien Supreme: “Krijuesi” (Dhatr), “Zoti i krijesave”(Prjapati), “Krijuesi i çdo gjëje” (Vishvakarman), “Drejtuesi i gjërave”(Vidhatr), “I qarti” (Dhartr), “Mbrojtësi” (Tratr), “Udhëzuesi”(Netr), “Krijuesi i trajtave” (Tvashttr) dhe “Gjallëruesi” ose “Rigjallëruesi” (Savitr). Një ndër emrat e tij ishte thjesht “I cili” (*Ka*) që nënkupton Atë që është i padepërtueshëm dhe përtej një përshkrimi të fundmë. Më vonë, *Ka* përdorej më së shumti për të përcaktuar Qenien Supreme.

God (Zot), fjala më e bukur në gjuhën angleze

Fjala angleze “God”(Zot) është një thesar gjuhësor e teologjik unik. Ajo daton që në parahistori, në periudhën e Neolitit, dhe rrjedh nga rrënja proto- Indoevropiane *gheu*, që do të thotë: “me thirr” ose “me u lut.” “God” është pjesore e së shkuarës që do të thotë “Ai të cilit i lutemi” ose “Ai në të cilin thërrasim.” Ashtu si sanskritishtja, persishtja, urdu dhe shumica e gjuhëve evropiane, anglishtja i përket familjes Indoevropiane. Fjala jonë “God” (Zot) – *Ghuto* në prejardhjen proto-indoevropiane – korrespondon me pjesoren e së shkuarës të sanskritishtes *huta* (“I luturi” ose “I thirruri”) e cila shfaqet në vedat indiane me epitelin e shenjtë *puruhuta* (I shumëluturi). Etimologjikisht “God” – “Ai I cili thirret në lutje” është I ngjashëm në kuptim me emrat biblikë *Elohim*, *Alaha* dhe emrin kuranor Allah, i cili, siç e kemi parë bart kuptimin e “ I adhuruari.” Po ashtu “God” është pothuajse i njëjtë në domethënie me fjalën e vendasve amerikanë të Lenape për Qenien Supreme, “Ai të cilit I lutemi.” Lutja dhe adhurimi janë të lidhura ngushtësisht. Profeti a.s thotë në një hadith të mirënjohur: “Lutja është thelbi i adhurimit”

Fjala angleze “God” (Zot) në formën e së tashmes është e lashtë dhe parakristiane, duke mos patur, kështu, lidhje, qoftë në mënyrë të fshehtë apo të drejtpërdrejtë, me teologjinë e Trinisë. Përdorimi historik më i hershëm i dokumentuar i fjalës gjendet në poemën *Beowulf*, poema më e vjetër në gjuhën angleze dhe poema epike në gjuhë amtare më e hershme evropiane. *Beowulf* rrëfen ngjarje parakristiane të fillimit të shekullit të gjashtë, rreth një gjeneratë para lindjes së profetit Muhamed a.s. Dijetarët perëndimorë e gjykojnë këtë poemë si paradoksale sepse asaj i mungojnë referimet tipike kristiane, por flet vazhdimisht për madhështinë e Zotit, duke e lëvdur në çdo rast Zotin e duke e falënderuar Atë. Fjala “God” në formën e saj të së tashmes është fjala më e përdorur për Krijuesin në poemë, por ajo përmban gjithashtu një sërë emrash madhështorë të shenjtë, të cilët janë ngulitur aq fort në tekstin e saj sa që nuk është e mundur që të jenë ndërfutur më vonë nga murgjit mesjetar.²¹ Ndonëse *Beowulf* ka lidhje me krijimin, Adamin, Noen, përmytjen, rilindjen, gjykimin, parajsën, dhe ferrin, ajo nuk përmban referime në ngjarjet biblike Moisiiane apo pas-Moisiiane, apo në Krishtin, kryqëzimin, dogmën trinitariane, shenjtoret, mbetje ose të tjerë elementë që priten të ndeshen në ndonjë redaktim pasues mesjetar. Poema deklaron qartë njësinë e Zotit e lartëson diturinë e Tij dhe sundimin e mëshirshëm të botës e njerëzve të Tij; ajo hedh poshtë e përqesh paganizmin si vepër të djallit dhe heroi epik, *Beowulf-i* – trim dhe i guximshëm, por njeri vërtet i përlulur ndaj Zotit – është i

angazhuar në luftë të përhershme me forcat djallëzore të së keqes dhe shkatërrimit.

Jo vetëm prej pranisë së shumë fjalëve për Zotin, por në përgjithësi fjalori religjioz i *Beowulf* shpreh me saktësi thelbin e vizionit shpirtëror dhe teologjik që muslimanët e gjejnë të shprehur aq mirë në gjuhën arabe. *Beowulf*-i është vërtetuese e pasurisë unike të gjuhës angleze dhe duhet të na frymëzojë ne, si muslimanë anglishtfolës, me respekt të thellë për gjuhën tonë dhe fuqinë e saj të qenësishme për të shprehur jo vetëm idenë tonë për Zotin, por edhe gjithë përmbajtjen e mësimin të hershëm profetik.

Përfundim

Është normale për muslimanët anglishtfolës që të kenë një dashuri të veçantë për fjalën Allah, me të cilën ne kemi një lidhje të brendshme, duke e përmendur përditë në pjesët e lutjes arabisht dhe në recitimin e Kuranit. Për ne fjala Allah ka një domethënie emocionale e shpirtërore që asnjë fjalë tjetër për Zotin nuk mund ta zëvendësojë. Por ajo rrallë e ka këtë domethënie për jo-muslimanët, apo ata që nuk dëgjojnë arabisht dhe disa prej tyre do ta paraqesin ndjeshmërinë tonë për këtë fjalë vetëm nëpërmjet dëgjimit të përsëritur shpesh të saj. Madje për disa edhe pas përpjekjeve për të qenë pa paragjykime, fjala “Allah” vazhdon të shkaktojë një sërë paragjykimesh kulturore të rrënjosura thellë dhe asociacione negative të vetëdijshme apo të nënvetëdijshme. Nga ana tjetër fjala “God”(Zot) krijon një reagim të menjëhershëm asociativ tek shumica e jomuslimanëve, folës vendas të anglishtes, gjë e cila do të ishte thuajse e pamundur për t’u arritur nga përdorimi i fjalës “Allah” edhe pas shumë vitesh pranë të saj.

Ashtu siç vlerësimi ynë për fjalën “Allah” nuk na shkëput nga përmendja e emrave të tjerë të bukur të Zotit në arabisht, ashtu edhe dashuria jonë për fjalën apo gjuhën arabe nuk duhet të na shtyjë ta pakësojmë përdorimin e fjalës së lashtë angleze “God”, me historinë e saj unike e të pasur midis trashëgimisë njerëzore të emrave të shenjtë. As folësit persianë apo urdu nuk duhet që besnikëria ndaj fjalës “Allah” t’i shtyjë të nënçmojnë fjalën e lashtë indoevropiane *Khoda* (Zot), e cila, ashtu si fjala “God” ka rrënjë monoteiste dhe të cilën, dijetarët e mëdhenj muslimanë, mistikët dhe poetët e kanë cilësuar si mjaft të përshtatshme në përdorimin e saj për më se një mijë vjet.²²

Kur flasim anglisht, le të flasim me mençuri, me respekt dhe me nderim. Dëshmia e besimit tonë, për shembull, në mënyrë koncize përkthehet: “S’ka Zot tjetër veç Zotit dhe Muhamedi është i dërguari i Tij.” Megjithatë, disa këmbëngulin në përkthimin e çdo pjese përveç fjalës më të rëndësishme: “S’ka Zot tjetër veç *Allahut*...” Ky përkthim i pjesshëm mund të shkaktojë pengesa të pajustificuara për dëgjuesit jomuslimanë dhe të nxisë një mori konotacionesh negative. Një përkthim i tillë kërkon patjetër shpjegimin e mëtejshëm se fjala “Allah” do të thotë “Zot”. Shmangia e përdorimit të fjalës “Zot” edhe pas kësaj trajtese (shpjegimi) krijon përshtypjen e gabuar se fjala “Zot”(God) është deri diku e papërshtatshme.

Të krishterët dhe hebrenjtë me të drejtë pyesin pse – kur fjala “Allah” dhe “God”(Zot) nënkuptojnë të njëjtën gjë – muslimanët sistematikisht e shmangin përdorimin e fjalës “God”, një stoli e gjuhësangleze, të cilën të krishterët dhe hebrenjtë e kanë përdorur për breza të tërë si mjaft të përshtatshmenë përthimin e fjalëve biblike *Elohim* dhe *Alaha*.Përgjegjësia është e jona, nëse, si pasojë e njëdashurie (ose vlerësimi) të pavend të gjuhës sonë të shenjtë krijojmë përshtypjen se nuk adhurojmë tënjëtin Zot apo se besojmë që “Allahu” ynë e tejkalon (ose përmbledh) Zotin biblik, Zotin e Abrahamit,Ishmaelit, Isakut, Jakobit, fiset e Izraelit, Moisiun, Jezusin dhe të gjithë profetët.

Përdorimi i fjalës “God”(Zot) thekson bazën e gjerë që ne ndajmë me tradita të tjera universale e Abrahamike dhe siguron një mënyrë të thjeshtë dhe bindëse nëpërmjet së cilës muslimanët mund të veprojnë në bazë të urdhrave kuranore për të theksuar të përbashkëtat midis nesh. Të neglizhuarit në përdorimin e fjalës “God” fsheh besimin tonë të përbashkët në Zotin e Abrahamit dhe vazhdimësinë e traditës Abrahamike të cilat janë rrënjësore për besimin tonë. Ne duhet t’i kapërcejmë mosbesimet (ose dyshimet) tona për fjalën “God” për arsye të vlerës së brendshme historike të saj dhe po ashtu sepse ajo na mundëson komunikimin me fqinjët tanë hebrenj, të krishterë e të tjerë anglishtfolës në një mënyrë të përshtatshme (ose kuptimplotë).

Shënime

¹ Siç u diskutua më poshtë, *Hubal*-i nuk ka lidhje teologjike apo historike me *Allahun*.

² Këto dhe referime të tjera gjenden lehtësisht në internet. Gjithsesi i detyrohem një kryeartikulli të shkëlqyer të New York Times (28 Janar 2004) të John Karney-it, të shkruar me rastin e Pelegrinazhit musliman, një rit islamik ngushtësisht i lidhur me Abrahamin. John Karney-i kundërshtoi mohimin (mospranimin) nga perspektiva e së djathtës fetare, të besimit abrahamik të përbashkët në Zotin biblik dhe nënvlerësimin e teologjisë muslimane dhe theksoi se një obskurantizëm i tillë ishte aq i rrezikshëm saç ishte edhe i pafalshëm.

³Etimologjia merret me studimin e historisë gjuhësore të fjalëve, duke e ndjekur zhvillimin e tyre në një gjuhë të caktuar dhe shpesh, duke bërë krahasime me fjalë të të njëjtit burim në gjuhë dhe dialekte të përafërta. Fjalët semite Allah (Zot në Kuran), Elohim e përdorur në Dhiatën e vjetër (Zot), dhe Alaha e armaishtes dhe siriakishtes së Dhiatës së Ri (Zot), etimologjikisht janë fjalë të një rrënje, siç e paraqet kryeartikulli i John Karney-t e siç sqarohet edhe më poshtë.

⁴ E kam përdorur “Historinë e shpëtimit” për t’iu referuar idesë religjioze se si Zoti sjell shpëtim përgjatë historisë njerëzore. Për hebrenjtë historia e shpëtimit zë vend në lidhjen e marrëveshjes së veçantë të Zotit me Bijtë e Izraelit. Në teologjinë kristiane historia e shpëtimit arrin kulmin me kryqëzimin e Krishtit dhe ringjalljen e tij. Historia e shpëtimit sipas Islamit pohohet në besimin tek mesazhi primordial i profecisë universale, e cila arrin kulmin me pejgamberllëkun e Muhamedit a.s që sqaron dhe përligj

gjithçka që u shpall para tij.

⁵ Kuran 16:123

⁶ Shiko, Kuran 6:161 ; 16:123 ; 22:78 ; 2:130,132,135 ; 3:67-68, 95 ; 4:125

⁷ Kuran 2:136

⁸ Kuran 26:46 ??????

⁹ Gjuhëtarët e klasifikojnë arabishten si gjuhë të vjetër semite ndërsa hebraishten, armaishten, siriakishten e etiopianen si gjysmësemite, edhe pse këto të fundit kanë qenë shkruar shumë kohë më parë se arabishtja. Arsyeja e këtij klasifikimi gjuhësor është se arabishtja ruan pothuaj të gjitha tiparet dalluese të gjuhëve protosemite – siç janë lakimi (eptimi), mbaresat e rregullta dyjare, dhe ndryshimet e plota bashkëtingëllore – të cilat, tek gjuhët gjysmësemite përgjithësisht kanë humbur apo janë shkrirë.

¹⁰ Hebrenjë ortodoksë e shmangin thirrjen e tetragramit dhe e zëvendësojnë me *Adonai* (Zoti im). Tradita judaike i referohet YHWH-së si “Emri” (*hash-Shem*) meqë besohej se përfaqësonte emrin më të shenjtë të Zotit, shqiptimi i të cilit ishte po aq i shenjtë dhe ruajtur me kujdes si i fshehtë. Njohja e “Emrit” ishte një trashëgimi karakteristike e rezervuar për klerikët më të lartë. Në ditën e shlyerjes së fajit, ai do ta thërriste atë në tempull dhe me përmendjen e tij, bashkësia e Izraelit do të gjunjëzohej përpara Zotit.

¹¹ Kuran 20:8

¹² Kuran 7:180

¹³ Kuran 59: 22-24

¹⁴ Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi, mbledhësit dhe vërtetuesit më rigorozë të haditheve në Islam. Folja e përkthyer këtu “mbron (shenjtërinë e tyre)” është *hafiza* dhe *ahsa* në shkrime të tjera. Ajo do të thotë t’i memorizosh (emrat e Zotit) dhe jo t’i shpërfillësh apo t’i harrosh, por gjithashtu t’i besosh ato, të kesh dije apo njohuri rreth tyre, dhe të jetosh në përputhje me atë këshillë, të kesh vetëdije për Zotin, të bësh atë që shërbyesi (robi) i Zotit duhet të bëjë dhe të largosh atë që duhet shmangur. Nëntëdhjetë e nëntë emrat e përmendur janë të listuar në një transmetim të “pranueshëm” (*hasan*) nga Tirimidhiu dhe nga burime të tjera me disa ndryshime të vogla.

¹⁵ Transmetuar në *Musnad-in* e Imam Ahmad ibn Hanbal.

¹⁶ Shiko Kuran 59:22-24 dhe 30:30

Ursprung der Gottesidee, 12 vol.(Munseri. W.: Achendorffsche Verlagsbuchhandlung, 1949)

¹⁹ Wilhelm Schmidt, Der Ursprung der Gottesidee, 8:193-194.

²⁰ Shiko Adolf Erman dhe Herman Grapoë, *Wörterbuch der ägyptischen Sprache*, 13 vols. (Berlin, Akademie Verlag, 1971). Nga ky fjalor arrita të mbledh mbi njëqind e njëzet emra të vjetër egjiptianë dhe attribute për Zotin, Krijuesin.

²¹ Emrat e mëposhtëm janë përmendur për Zotin në poemën *Beowulf*: Zot, Zoti i Shenjtë (*Haling God*), Zoti i Urtë (*witig God*), Zoti i fuqishëm (*mihting God*), Zoti i lartë (*Drihten*), Zoti i Lartë suar (*Drihten God*), Zoti i lartë i përjetshëm (ece *Drihten*) (*Drihten* gjendet gjithashtu i shoqëruar me mbiemrat “I shenjtë” “I ditur” dhe “I fuqishëm”); Krijuesi (*Scyppend*); Zoti i jetës (*Liffrea*), Rregulluesi i fatit (*Metod*); rregullues paraekzistent i fatit (*Ealdmetod*); Lavdiploti rregullues i fatit (*scir Metod*); Zoti i vërtetë, Zoti i fatit ose Zoti i vërtetë (*sod Metod*); Zotëruesi madhështor i gjithçkaje (*Alwalda*); Zoti i fuqishëm (*Wealdend*); Zoti i fuqishëm i Lavdisë (*wldres Wealdend*); Zoti i njeriut (*ylda Waldend*); Zoti i njerëzimit (*Wealdend fira*); Zoti i fitoreve (*sigora Wealdend*); mbreti i madhështisë (*Cyninga ëuldor* dhe *Wuldurcyning*); Mbreti i vërtetë (*Sodcyning*); Zoti i vërtetë i fitoreve (*sigora Sodcyning*); Ati dhe Ati i plotfuqishëm (*Faeder* dhe *Faeder Alwalda*); Zoti i çdo gjëje (*Frea ealles*); Mbrojtësi i njerëzimit (*manna Gehyld*); Mbrojtësi i lavdisë (*wuldres Hyrde*); i gjithfuqishmi (se *AEImihtiga*); Gjykuesi i veprave (*daeda Demend*); Ruajtësi i parajsës (*heofena Helm*) dhe Zotëruesi i qiejve (*rodera Raedend*). Shiko Fr. Klaeber, *Beowulf and the Fight at Finnsburg*

. (Boston: D. C. Heath, 1950), pp. xviii-li and 1-120.

²² *Khoda* vjen nga fjala e vjetër iraniane (Indoevropiane) *Hwa-Taw* që fjalë për fjalë do të thotë “vetvetiu i aftë” ose “vetvetiu i fuqishëm” që është “Sundimtari” dhe “Zoti”. Ai është një emër i madhështisë që tregon se Zoti është i plotfuqishëm prej vetiu. Pavarësisht se fjala angleze “God” dhe persianja “Khoda” janë të dyja indoevropiane dhe japin përshtypjen sikur janë të afërta, në fakt ato rrjedhin nga rrënjë të ndryshme.

Date Created

16/10/2014

Author

erasmusi